

URDHËR
Nr. 7, datë 5.1.2018

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, neni 26 i rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar me urdhrin nr. 150, datë 26.9.2017,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave që lidhen me procedurat e verifikimit të sigurisë së individëve që aplikojnë për CSP-në dhe operatorëve ekonomikë që aplikojnë për CSI-në, z. Mark Ndreca, me detyrë, drejtori i Drejtorisë së *Vetting*-ut dhe Sigurimit Industrial.

2. Autorizoj z. Ndreca të kryejë veprimet si më poshtë:

- a) Të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese për verifikimin e sigurisë.
- b) Të firmosë shkresat me të dhënat e operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht drejtuar autoriteteve kontraktore.
- c) Të firmosë shkresat për përditësimin e rekordeve të operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.
- d) Të firmosë shkresat përcjellëse për dërgimin e CSP-së tek institucionet shtetërore.

3. Ky urdhër do të jetë në fuqi deri në datën 31.12.2018.

4. Z. Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Mark Ndreca, drejtor i Drejtorisë së *Vetting*-ut dhe Sigurimit Industrial; dhe arkiv/protokolli i DSIK-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Dorian Tola